

Në bazë të dispozitave të nenit 5, paragrafit 5.2, të nenit 16, të Ligjit nr. 03/L-087, për ndërmarrjet publike ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", me 31/15 qershor 2008), të nenit 17, paragrafi 17.4a, të Ligjit nr. 05/L-009 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 04/L-111 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", me 10/07 maj 2015), të konkursit të shpallur me dt.25.05.2018 për anëtarë të Bordit të Drejtorëve të Ndërmarrjes Publike "Termokos" Sh.A, Komisioni komunal i aksionarëve për ndërmarrjen publike lokale "Termokos", në përbërje të z. Ardian Olluri, znj. Arbenita Murseli, z.Nol Nushi në mbledhjen e mbajtur më 02.07.2018, merr këtë:

## **V E N D I M**

### **Neni 1**

Emërohen anëtarë të bordit të drejtorëve të Ndërmarrjes Publike Lokale "Termokos" SH.A.:

- Hasan Preteni
- Adnan Preniqi
- Fatmir Sopi
- Driton Hyseni

### **Neni 2**

Detyrat e anëtarëve të bordit të drejtorëve janë të përcaktuara në Ligjin nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike, Statutit nr.795 dt.06.09.2011, të Ndërmarrjes Publike Komunale "Termokos" SH.A.

### **Neni 3**

Mandati i anëtarëve të Bordit të drejtorëve është tre (3) vjet.

### **Neni 4**

Kompensimi i drejtorëve të bordit do të bëhet në pajtim me dispozitat e nenit 20, paragrafi 20.2 të Ligjit nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike.

### **Neni 5**

Për kryerjen e detyrave të cekura në pikën 3 të këtij Vendimi, Bordi i drejtorëve i raporton Komisionit komunal të aksionarëve.

**Neni 6**

Ky vendim hynë në fuqi në ditën e marrjes së tij.

**Anëtarët e komisionit komunal të aksionarëve:**

Ardian Olluri \_\_\_\_\_

Arbenita Murseli \_\_\_\_\_

Nol Nushi \_\_\_\_\_

**U dorëzohet:**

- Të emëruarve;
- Në dosje.

